QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT
Nr. 17655 Prot.
Datë 30.06.2022

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË**

DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË

TDR GROUP

Nr. **859** Prot

Tiranë, më 29.06.2022

Nr. 2270 Dosje

**VENDIM**

PËR PUSHIMIN E EKZEKUTIMIT

Unë, Florian Shehu, me detyrën e Përmbaruesit Gjyqësor, pranë Zyrës së Përmbarimit Privat "TDR GROUP" sh.p.k, në referim të Urdhërit të Ekzekutimit Nr.14248, të lëshuar me datë 07.12.2021 prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kam vënë në ekzekutim këtë Urdhër, duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr.2270, Datë 31.05.2022 kërkesën e kreditorit Shoqëria "DELOITTE ALBANIA SH.P.K", me NIPT J62329003N ndaj debitorit Shoqëria "EA TOBACCO" Sh.p.k me NIPT L62002012I në lidhje me Titullin Ekzekutiv Faturë Tatimore Shitje Nr.877, datë 23.10.2018.

Pasi mora Vendimin Nr.694 Prot, Datë 01.06.2022 për fillimin e menjëhershëm të ekzekutimit të detyrueshëm, referuar nenit 519 të K.Pr.Civile, është kaluar në vënie sekuestrosh konservative tek pasuritë e tij.

Urdhër për vendosjen e sekuestros konservative është dërguar në:

a) Bankat Tregtare të Nivelit të Dytë, me shkresën Nr.695 Prot, Datë 01.06.2022 të Zyrës së Përmbarimit Privat "TDR GROUP" sh.p.k.
b) Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB - Tiranë), me shkresën Nr.698 Prot, Datë 01.06.2022 të Zyrës së Përmbarimit Privat "TDR GROUP" sh.p.k.

Lidhur sa më sipër, duke zhvilluar dhe kryer veprimet proceduriale të nevojshme përmbarimore,

**KONSTATOJ**

Se detyrimi i përcaktuar në Urdhërin e Ekzekutimit Nr.14248, të lëshuar me datë 07.12.2021 prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lëshuar për titullin ekzekutiv Faturë Tatimore Shitje Nr.877, datë 23.10.2018, është ekzekutuar tërësisht nga ana e Shoqëria "EA TOBACCO" Sh.p.k me NIPT L62002012I.

Në këto kushte, referuar nenit 616, pika "a" të Kodit të Procedurës Civile dhe Ligjit Nr.26/2019 "Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat",

## VENDOSA

1. Pushimin e ekzekutimit të Urdhërit të Ekzekutimit Nr.14248, të lëshuar me datë 07.12.2021 prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

2. Urdhërohen Bankat Tregtare të Nivelit të Dytë, të zhbllokojnë nga masa e sekuestros konservative depozitat, kredite apo llogarite bankare të **Shoqëria "EA TOBACCO" Sh.p.k me NIPT L62002012I**, bllokuar me shkresën *Nr.695 Prot, Datë 01.06.2022* të Zyrës së Përmbarimit Privat "TDR GROUP" sh.p.k.

3. Urdhërohet Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB - Tiranë), të zhbllokojë nga masa e sekuestros konservative menjehere aksionet e zotëruara nga **Shoqëria "EA TOBACCO" Sh.p.k me NIPT L62002012I**, bllokuar me shkresën *Nr.698 Prot, Datë 01.06.2022* të Zyrës së Përmbarimit Privat "TDR GROUP" sh.p.k.

4. Një kopje e vendimit të pushimit t'i dorëzohet palëve në procesin përmbarimor.

5. Ky vendim mund të ankimohet përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, brenda 5-ditësh nga marrja dijeni.

**ZYRA E PËRMBARIMIT PRIVAT "TDR GROUP" sh.p.k.**

**PËRMBARUESI GJYQËSOR**

**FLORIAN SHEHU**

Zyra e Përmbarimit Privat "TDR Group"sh.p.k
Adresa : Bulevardi "Gjergj Fishta" Kulla Nr. 5 ,Kati i 11-të , Nr.54 Tiranë
Tel : 00355 42 427790
www.tdr.al